

**Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm
(KOSID)**

Struktura tarifore e energjisë elektrike

**Përgjigje ndaj Raport Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë
(ZRRE) rreth Strukturës Tarifore**

Shkurt 2014



GAP, INDEP në kuadër të KOSID

Përgatitur nga:

Dren Pozhegu (Instituti GAP)

RinoraGojani (Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP)

Copyright © 2014 GAP, INDEP

Hyrje

Më 11 shkurt 2014, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) publikoi raportin konsultativ rreth strukturave tarifore të energjisë elektrike në Kosovë. Në këtë raport, ZRRE për herë të parë shqyrton opsionet e ndërrimit të strukturës tarifore të energjisë elektrike në Kosovë.

Ky shqyrtim i strukturës tarifore vie si rezultat i pakënaqësive sociale rreth faturave të energjisë elektrike. Kjo pakënaqësi morri formën e protestës në fillimin e viti 2013, kur një grup i madh i qytetarëve protestuan kundër ‘fryrjes’ së faturave të energjisë elektrike. Si rezultat i presionit të protestave, Kuvendi i Kosovës inicoi një komision hetimor i cili do të ishte përgjegjës për hulumtimin e shkakut të pakënaqësive dhe keqpërdorimeve eventuale të institucioneve relevante. Më vonë, ZRRE doli me një raport ku shpjegohet që arsyet e pakënaqësive nuk ishin rezultat i vjedhjeve dhe keq menaxhimit nga operatori mirëpo si rezultat i tarifave dhe formës së kalkulimit të energjisë elektrike e cila është tejet komplekse dhe e pakuptueshme për shumicën e qytetarëve.

Komisioni hetimor i Kuvendit të Kosovës, pas përfundimit të hulumtimit, rekomanduan ndër të tjera ndërrimin e strukturës së tashme tarifore të energjisë elektrike. Mëspecifikisht, komisioni hetimor rekomandoi që struktura tarifore të jetë shumë më e thjeshtë, dhe sugjeruan që të eliminohet ndarja në blloqe.

Tarifat e energjisë shqyrtohen dhe përcaktohen çdo vit nga ZRRE. Procesi i shqyrtimit të tarifave përfundon në prill të çdo viti dhe përgjatë procesit ZRRE konsulton të gjitha aktet relevant në fushën e energjisë dhe gjithashtu organizon konsultime publike. Ky reagim nga organizatat e Konsorciumit të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), do argumentojnë për opsionin më të përshtatshëm për rrethanat e shoqërisë Kosovare.

Tarifat e tanishme

Tarifat e tashme për konsumatorët në Kosovë janë të zbatueshme deri më 31 mars 2014. Momentalisht në Kosovë ekzistojnë tri bllok tarifa në bazë të cilave kategorizohen dhe llogariten shpenzimet e konsumatorëve të amvisërisë në baza mujore janë: 0–200 kWh, 200–600 kWh, dhe më shumë se 600 kWh. Një ndarje tjetër është sezona e ulët (verës) nga 1 Prill – 30 Shtator dhe sezona e lartë (dimrit) nga 1 Tetor – 31 Mars. Tarifat gjithashtu ndryshojnë varësisht nga koha ditore e konsumit të energjisë, apo siç quhen tarifa e ulët dhe tarifa e lartë. Tarifa e lartë gjatë sezonës së dimrit është nga 07:00-22:00 dhe e ulëta nga 22:00-07:00, ndërsa gjatë sezonit të verës tarifa e lartë është nga 08:00 – 23:00 dhe e ulëta 23:00-08:00. Vlen të përmendët që dallimi mes tarifës së lartë dhe tarifës së ulët është pothuajse 100% e çmimit siç shihet edhe nga tabela e mëposhtme.

	Sezona e ulët (vera)		Sezona e lartë (dimri)	
	1 Prill – 30 shtator		1 tetor – 31 mars	
	€cent/kWh		€cent/kWh	
Blloku	Tarifa e ulët 23:00-08:00	Tarifa e lartë 08:00 – 23:00	Tarifa e ulët 22:00-07:00	Tarifa e lartë 07:00-22:00
<200kWh/muaj	1.81	3.63	2.54	5.05
200-600 kWh/muaj	2.51	5.01	3.51	7.00
>600 kWh/muaj	3.65	7.27	5.07	10.16

Megjithatë, duhet sqaruar që për të ardhur deri tek tarifat, ZRrE vendos për tëArdhurat Maksimale të Lejuara (AML). AML përcaktohen nga një sërë faktorësh¹ qëndikojnë në koston e prodhimit të energjisë. Pasi që ZRRE shqyrton arsyeshmërinë e kostove të prodhimit të energjisë, bën përcaktimin e AML-së, që nënkupton që operatorët ekonomik në fushën e energjisë nuk lejohen të kenë të ardhura më të mëdha se ato të caktuara. Pra AML për operatorët energjetik janë të njohura para se të caktohen tarifat. Rrjedhimisht, procesi i përcaktimit të tarifave nuk nënkupton përcaktimin e të ardhurave për operatoret energjetik por vetëm përcaktimin e mënyrës se kur dhe kush do te kontribuojë në mbledhjen e këtyre të ardhurave.

Nga raporti konsultativ i ZRrE të publikuar në mesin e muajit shkurt, prezantohen opsionet për të tri kategoritë tarifore – ndryshimet ditore të tarifave, ndryshimet sezonale, dhe bllok tarifa – dhe elaborohen avantazhet dhe disavantazhet e të gjitha këtyre opsioneve. Megjithatë, ZRrE nuk merr pozicion për asnjërën prej opsioneve. Opsioni i parë që prezantohet në këtë raport është ndryshimet potenciale në tarifën sezonale prej tarifave për të dy sezonat, në një tarifë të vetme. Opsioni i dytë shqyrton tarifat ditore dhe shtjellon mundësinë e ndryshimit të tarifës ditore nga ajo momentale (dy tarifa) në një tarifë të vetme, apo në modifikimin e tarifës së tanishme, apo mëspefifikisht nëndryshimin e kohës së aplikimit të tarifës së lartë. Opsioni i tretë shqyrton mundësinë e ndryshimit të bllok tarifës nga e tanishmja në modifikimin në vetëm dy bllok tarifa, apo në eliminimin e plotë të blloqeve tarifore.

¹ Disa prej këtyre faktorëve ndahen në dy pjesë: kostoja operative dhe kostoja e investimeve kapitale. Në koston operative futen ndër të tjera kostoja e ekstraktimit të linjitit, kotoja e zhvlerësimit të teknologjisë, dhe kostoja e fuqisë punëtore.

Rekomandimi i KOSID

KOSID rekomandon që sistemi tarifar momental të mbetet edhe më tej i njëjti. Edhe pse sistemi tarifar momental është relativisht kompleks dhe shkakton paqartësi tek konsumatorët shtëpiak, KOSID mendon që ky sistem i përshtatet më së miri situatës së tanishme të konsumit të energjisë dhe situatës socio-ekonomike. Megjithatë, faturat e energjisë elektrike duhet të modifikohen në atë mënyrë që të jenë më të kuptueshme për të gjithë konsumatorët. Këto modifikime mund të përfshijnë një shpjegim më të mirë të mënyrës së kalkulimit të shpenzimeve, dhe një pasqyrim më të qartë të shpenzimeve të energjisë elektrike.

Tarifa sezonale

Mbajtja e tarifave sezonale është e rëndësishme për dy arsye: stimulimi i përdorimit të burimeve alternative për ngrohje dhe uljes së konsumit të energjisë elektrike.

Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohje është praktikë e gabuar. Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohje është mënyrë jo efiçiente e përdorimit të energjisë dhe në relacion me burimet tjera alternative është më e shtrenjtë. Ndërsa arsyeja e dytë ka të bëjë me mungesën e kapaciteteve të gjenerimit të energjisë elektrike në Kosovë. Në qoftë se energjia elektrike përdoret edhe për ngrohje, kërkesa për energji rritet në atë nivel sa është e pamundur të mbulohet me kapacitete vendore. Andaj si rezultat i kësaj furnitorët e energjisë detyrohen të importojnë energji elektrike nga jashtë. Energjia e importuar është shumëfish më e shtrenjtë se energjia e prodhuar në vend. Si pasojë e importit të energjisë rritet AML për furnitorin.

Të gjitha këto arsye reflektojnë në çmim më të lartë për energjinë elektrike.

Tarifa ditore

Mbajtja e tarifës ditore është e rëndësishme për një arsye thelbësore. Kapacitet gjeneruese të energjisë elektrike në Kosovë janë jo-fleksibile. Prodhimi i energjisë nga termocentralet nuk mund të ndryshohet në bazë të kërkesës për energji. Për shkak të specifikave teknologjike, prodhimi i energjisë nga termocentralet duhet të jetë sa më konstant që është e mundur. Në anën tjetër, kërkesa për energji elektrike gjatë ditës varion. Kjo shkakton mungesë tëbalancit në mes të kërkesës dhe ofertës, e cila balancohet vetëm përmes eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Meqë konsumi më i lartë i energjisë elektrike, apo piku i kërkesës, koïncidon me pikun e vendeve tjera nga ku bëhet importi i energjisë, energjia e importuar rezulton me çmime tejet të larta. E njëjta nuk vlen për eksportet e energjisë. Gjatë periudhës së natës në Kosovë, prodhohet më shumë energji sesa që konsumohet. Konsumi më i vogël gjatë natës është jo vetëm në Kosovë por edhe në vendet ku Kosova eksporton energji. Si rezultat, çmimet e eksportit janë shumë të ulëta.

Tarifat e ndryshme gjatë ditës stimulojnë shtrirjen në mënyrë sa më të barabartë gjatë ditës në mënyrë që të mos krijohet mbingarkesë gjatë disa orëve të ditës.

Bllok tarifa

Mbajtja e bllok tarifave të energjisë elektrike në Kosovë (0-200, 200-400 dhe >600) është forma më e përshtatshme për arsye socio-ekonomike. Me mbajtjen e bllok tarifave i mundësohet ekonomive familjare me të ardhura më të vogla, energji elektrike me çmime të përbalueshme. Duke e pasur parasysh që ka një numër të madh të familjeve me të ardhura të limituara, një sistem i tillë tarifar do të ju bën të mundur pagesën e energjisë së konsumuar.

Gjithashtu, sistemi i bllok tarifës nxitë të gjitha ekonomitë familjare të bëjnë menaxhimin e konsumit mujor në atë mënyrë që të paguajnë më pak për energjinë e konsumuar. Kjo rezulton në konsum më të kontrolluar të energjisë elektrike dhe në përgjithësi në kursim të saj.

Rreth bllok tarifës është thënë disa herë që pjesa më e madhe e faturimit bëhet nga konsumatorët që bijnë në bllok tarifën e tretë. Është e vërtetë që konsumatorët më të mëdhenj të energjisë elektrike paguajnë më shumë në relacion me konsumatorët më të vegjël, dhe kjo nënkupton në një mënyrë subvencionim të konsumit nga ana e konsumatorëve të mëdhenj ndaj atyre të vegjël, madhësia e ‘subvencionimit’ është shumë më e vogël se ç’paramendohet. Këtu duhet cekur raportin e Komisionit Hetimor të Kuvendit të Kosovës i cili konkludon që për vitin 2012, 58.5 përqind e energjisë elektrike është konsumuar në bllok tarifën e tretë. Kjo shifër nuk qëndron, për arsye se 58.5 përqind reflekton të gjithë konsumin e ekonomive familjare të cilët konsumojnë më shumë se 600 kWh (bllok tarifa e tretë), por nuk reflekton për konsumin e energjisë elektrike që është bërë vetëm në bllok tarifën e tretë. Thënë ndryshe, komisioni hetimor e ka kalkuluar të gjithë energjinë e ekonomive familjeve që tejkalojnë limitin prej 600 kWh, por nuk i zbret nga kjo konsumin i cili është faturuar në bllok tarifën e parë dhe të dytë.

Përkundër kompleksitetit që ka sistemi i tarifave të energjisë elektrike në Kosovë, KOSID konsideron që sistemi momental tarifar i përshtatet më së miri kohës dhe gjendjes socio-ekonomike. Megjithatë, faturat e energjisë elektrike duhet të modifikohen në atë mënyrë që të jenë më të kuptueshme për të gjithë konsumatorët. Këto modifikime mund të përfshijnë një shpjegim më të mirë të mënyrës së kalkulimit të shpenzimeve, dhe një pasqyrim më të qartë të shpenzimeve të energjisë elektrike.